

**AKT - THEMELIMI**  
**i**  
**Shoqërisë “TIK CONSULTING” sh.p.k”**

**Neni 1**

**Emërtimi dhe statusi ligjor**

Sot në Tiranë më datë 01.10.2019 (dymijeenentembedhete),

**Z. TAULANT MUÇA** –me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me dokumetin e identifikimit Pasaporte Nr.BE0539840, Nr.Personal I90818055W i vlefshme deri me date 24.05.2021, atësia Murat, i datelindjes 18.08.1989, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rr. “Kadillari” Lagjja Ali Demi Nr.27, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe juridike, **në cilësinë e themeluesit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “TIK CONSULTING” sh.p.k”**.

**Neni 2**

**Simboli dhe vula zyrtare**

Shoqëria ka vulën dhe simbolin e saj. Vula përdoret për dokumentet dhe raportet e ndryshme të lëshuara prej tij në drejtim të palëve të treta apo enteve të tjera publike ose private. Të drejtën e vendosjes së vulës e ka Drejtori ekzekutiv apo një person tjetër i autorizuar prej tij. Vula vendoset mbi aktet e ndryshme që nënshkruhen prej personave që i njihet e drejta për t'i nënshkruar ato.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria **“TIK CONSULTING” shpk**, e ushtron aktivitetin e tij në të gjithë territorin e Shqipërisë. Selia e saj është në Tiranë, në adresën: **Rruga “Petro Nini Luarasi” Njesia 5, Hyrja 3 Tiranë**.

Shoqëria **“TIK CONSULTING” shpk**, duke patur parasysh nevojat e saj mund të hapë zyra përfaqësimi dhe/ose degë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto degë nuk janë persona juridikë

të veçantë por pjesë të shoqërisë. Gjithashtu, mund të krijohen degë ose filiale të shoqërisë, jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 4**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë **“TIK CONSULTING”shpk**, është e pakufizuar në kohë. Aktiviteti i tij përfundon nëse është arritur qëllimi i tij ose ky i fundit bëhet i porealizueshëm, por gjithmonë në përputhje me ligjet shqiptare dhe me këtë statut. Personaliteti juridik i shoqërisë mbaron në ditën kur shoqëria ç’regjistrohet në QKB.

**Neni 5**

**Themeluesit**

Themeluesi i Shoqërisë **“TIK CONSULTING” shpk**, është;

**Z. TAULANT MUÇA** –me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me dokumetin e identifikimit Pasaporte Nr.BE0539840, Nr.Personal I90818055W i vlefshme deri me date 24.05.2021, atësia Murat, i datelindjes 18.08.1989, lindur dhe banues në Tiranë, në adresën Rr. “Kadillari” Lagjja Ali Demi Nr.27, Tirane.

## **Kapitali**

Kapitali fillestar i shoqërisë “TIK CONSULTING” shpk, është 100,000 (njqindmije) Lekë te reja, i ndarë në 1 (nje) kuote,

Pjesëmarrja e ortakut themelues në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- **Z. TAULANT MUÇA** zotëron 1 kuotë që përfaqëson 100 % të pjesëve të kapitalit, me vlerë 100,000 (njqindmijë) lekë të reja;

## **Qëllimi dhe objektivat e Shoqërisë**

“Sherbime te konsulences ligjore, burimecve njerezore, kontabiliteti, sherbime te fushes se ndertimtarise, real estate, shitje dhe blerje te materialeve te ndertimit, auditim dhe certifikim te standarteve ISO dhe cdo sherbim tjetër qe konsiderohet fitimprures per shoqerine

## **Neni 8**

Organet drejtuese të shoqërisë “TIK CONSULTING” shpk,

- Administratori;
- Asambleja e Përgjithshme.

## **Neni 9**

### **Burimet Financiare**

Burimet financiare të shoqërisë që janë të domosdoshëm për përmbushjen e qëllimeve të tij sigurohen në mënyrë të ligjshme nga të ardhurat që sigurohen nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të shoqërisë.

## **Neni 10**

### **Përfaqësuesi ligjor**

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, është Administratori i Shoqërisë “TIK CONSULTING” shpk,, **Z. TAULANT MUÇA**.


## **Neni 11**

### **Drejtimi**

Rregullat për funksionimin dhe drejtimin e shoqërisë janë parashikuar në Statutin e tij që shoqëron këtë Akt Themelimi.

## **Themelues**

**Z. Taulant MUÇA**



\_\_\_\_\_  
“TIK CONSULTING” shpk,